

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"EURO SKELA" sh.p.k

Themeluesit e Shoqërisë Tregtare të mbledhur sot me datë 26/03/2025, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi në Republikën e Shqipërisë, në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, ligjin Nr. 131, datë 26.11.2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", VKM Nr. 537, datë 01.08.2007 "Për Rregullat për Emrat dhe Emërtimet Tregtare" i ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë dhe të shprehur vendosën themelimin e shoqërisë "EURO SKELA" sh.p.k.

KREU I
KRIJIMI, EMRI, FORMA, VULA, SELIA, TERRITORI

Neni 1
Ortakët Themelues dhe Emri

1. Ortakët themelues të shoqërisë janë:

- **Z.Agustin Marashi**, me atesi Prend, i datelindjes 02.06.1978, lindur ne Puke dhe Banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr.H80602065K.
- **Shoqëria "ALBES INVEST" sh.p.k** person Juridik Shqiptar, i regjistruar si i tille prane Regjistririt Kombetar ne QKB, pajisur me Nipt M17821501K, me adrese kryesore Shengjin Rruga e "Plazhit" Godina Nr.35, Kati 1, perfaqesur nga administratori Z. Besnik Paluca, me atesi Prend, i datelindjes 28.02.1982, lindur në Lezhë dhe banues në Tirane, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr. I2022 8193A.

2. Ortakët themelues për sa më lartë cituar vendosën krijimin e shoqërisë tregtare me emërtimin **"EURO SKELA" sh.p.k**

Neni 2
Forma dhe Vula

1. Shoqëria Tregtare krijohet si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Themeluesit e saj janë persona fizik dhe juridik të cilët kanë derdhur kontributin e tyre në kapitalin e Shoqërisë, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që burojnë nga veprimtaria e shoqërisë, duke mos u përgjigjur për detyrimet e Shoqërisë, por duke mbuluar personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Për mënjanimin e çdo dyshimi, Ortakët gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributeve përkatëse të tyre në kapitalin e përfaqësuar në pjesë kapitali;



2. Çdo akt apo dokument që do të dali nga Shoqëria në marrëdhënie me personat e tretë duhet të tregojë dukshëm emrin e Shoqërisë, vulën (brendësia e së cilës përmban emrin dhe formën juridike) dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose shkurtimisht inicialet "Sh.P.K" si dhe nënshkrimin e administratorit.

Neni 3 Selia

1. Selia e shoqërisë është e vendosur në Tiranë, në adresën: Njësia Nr.9, Rruga Don Bosko, pranë Kompleksit Vizion Plus, Tiranë, Shqipëri, me adresë elektronike "euroskela@gmail.com".
2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Ortakëve. Shoqëria do ta konsiderojë selinë e përcaktuar më sipër si Shoqëria Mëmë, e cila rast pas rasti me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve mund të hapë degë, filiale ose shoqëri të përbashkëta në të gjithë ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit për të cilën krijohet.

Neni 4 Territori


Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ku në varësi të ecursisë së veprimtarisë ekonomike nuk përjashton zhvillimin e mëtejshëm të këtij aktiviteti edhe jashtë territorit të saj.

KREU II OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 5 Objekti

1. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

Dhënie me qira e skelave dhe shërbime të tjera për skelat (prodhim, tregtim, montim, çmontim). Punime të ndryshme ndërtimi për të gjitha llojet dhe kategoritë. Instalime impiantesh të ndryshme. Lyerje, patinim, dyer dhe dritare. Ndërtimi i objekteve civile dhe industriale. Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit. Aktivitet në fushën e imobiliareve: blerje, shitje dhe qira e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme. Punime ndërtimi dhe restaurimi për objekte të ndryshme. Hapja dhe operimi i hoteleve dhe kampingjeve. Aktivitetet e argëtimit për fëmijë dhe të rritur: Bare, restorante, lavazhe, parkime, dhe aktivitete të tjera rekreative. Shërbime transporti (taksi, transport udhëtarësh dhe mallrash brenda dhe jashtë vendit). Shitje dhe qira e automjeteve dhe makinerive të ndryshme. Aktivitetet e agjencive të udhëtimit dhe turizmit. Tregti me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, industriale dhe kozmetike. Tregti elektroshtëpiake dhe paisjeve elektronike. Prodhim, ambalazhim, tregtimi dhe shpërndarja e ujit natyral, pijeve freskuese



dhe produkteve ushqimore. Përpunimi dhe tregtimi i lëndës drusore, mobiljeve, pllaka, parkete dhe materialeve të lejuara në fushën e ndërtimit. Grumbullim dhe tregtim i materialeve të ndryshme si hekur, alumin, bronz, bakër dhe lëndë të tjera të riciklueshme (skrap). Shitje e materialeve plastike. Punime në hidrocentrale dhe përpunim të materialeve industriale (zhavorre, gelqeror, ranor, etj.) Aktivitet në fushën e sigurisë private. Shërbime dhe asistencë për hidrocentrale dhe punime të ndryshme në karrierë. Import-eksport i produkteve ushqimore, pijeve dhe materialeve të tjera të lejuara nga legjislacioni. Importi dhe eksporti i kafes, pijeve dhe produkteve ushqimore. Rritja dhe mbarështimi i kafshëve dhe ngritja e fermave. Agroturizëm dhe aktivitete të lidhura me bujqësinë dhe natyrën. Arkitekturë dhe aktivitete inxhinierike (projektim, konsulencë dhe zbatim). Trajnime dhe kurse në fusha të ndryshme si hospitality, turizëm, etj.

Neni 6 **Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në QKB, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj, në statut ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

KREU III **AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI**

Neni 7 **Fusha e Veprimtarisë së Ortakëve**

1. Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjestim me kontributin e dhënë në kapital. Fusha e autoritetit të secilit ortak dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzojnë ortakët në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut dhe ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 8 **Libri i Shoqërisë**

1. Shoqëria për të saktësuar dhe ligjëruar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës do të mundësojë çeljen e librit të vet që mbanë librat kontabël, hartimin dhe publikimin e të dhënave financiare, raportet për ecurinë e veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

Neni 9 **Konfidencialiteti**

1. Shoqëria në ushtrimin e veprimtarisë së saj ekonomike udhëhiqet nga parimi i konfidencialitetit, dhe ruajtja me besnikëri e të dhënave që do të disponojë Shoqëria si dhe mos ekspozimin e tyre ndaj personave të jashtëm.

KREU IV KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

Neni 10 Kapitali Themeltar dhe Zotërimi i Kuotave

1. Kapitali Themeltar i Shoqërisë është në vlerën **100,000 (njëqindmijë) Lek.**
2. Kapitali themeltar është i ndarë në **2 (dy) kuota;**
3. Ortakët e Shoqërisë zotërojnë kuotat sipas kontributeve në kapitalin e Shoqërisë si më poshtë:
 - **Z.Agustin Marashi** i cili zotëron 1 kuotë, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek, të llojit në kontribut "Para", me pjesëmarrje në përqindje në masën 50 %; e barabartë me 1 (një) kuotë.
 - **Shoqeria "ALBES INVEST" sh.p.k,** i cili zotëron 1 kuotë, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lek, të llojit në kontribut "Para", me pjesëmarrje në përqindje në masën 50 %; e barabartë me 1 (një) kuotë.

Neni 11 Transferimi i Kapitalit dhe e Drejta e Parablerjes

1. Pjesët e Kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial ose automatikisht në rrugë trashëgimie;
2. Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri kjo vetëm me miratimin e unanimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
3. Transferimi për çfarëdo arsye, tërësisht apo pjesërisht i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit;
4. Në rast se ortaku i cili mban të drejtën e parablerjes nuk përgjigjet ose nuk shfaq interes për pjesën e kuotës që do të shitet, atëherë ai konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e parablerjes së pjesës së kapitalit që do të tjetërsohet;
5. Çdo transferim i kapitalit themeltar bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar;

KREU V STRUKTURA, ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 12 Organet Drejtuese



1. Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme.
2. Administratori.

Neni 13 Asambleja e Përgjithshme

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë së përgjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron;
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë të autorizuar me prokurë (përfshihet përfaqësimi i një ortaku nga një ortak tjetër apo administratori i shoqërisë);
3. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme;
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese më të njëjtin rend dite;
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori, eksperti kontabël i autorizuar, po qe se ka të tillë, nga likuiduesit apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Këta ortakë mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës;
6. Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar;
7. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe tu lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës, pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari i saj.
8. Nëse në kundërshtim me piken 13.5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*". Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme bëhet nga administratori.
9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet si më poshtë vijon:
 - a. Përcakton politikat tregtare të shoqërisë;



- b. Vendos për ndryshimet e statutit, kalimin e kuotave, zmadhim/zvogëlim të kapitalit;
 - c. Emëron dhe shkarkon administratorin;
 - d. Vendos për krijimin e shoqërive të reja, hapjen e degëve/filialeve ose për krijimin e shoqërive të përbashkëta me shoqëri të tjera private dhe/ose publike;
 - e. Emëron dhe shkarkon likuiduesin dhe ekspertin kontabël të autorizuar nëse ka të tillë;
 - f. Përcakton shpërblimet për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabël të autorizuar;
 - g. Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - i. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - j. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investimet; d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
11. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Neni 14 Administratori dhe Kompetencat

1. Shoqëria do të ketë një ose disa administrator, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme pas krijimit të shoqërisë në QKB. Administratori i parë i shoqërisë emërohet **Z. Agustin Marashi** për një afat prej 5 (pesë) vjetësh me të drejtë riemërimi;
2. Kompetencat e administratorit në mënyrë konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e emërimit;
3. Administratori në rast kur nuk është ortaku i vetëm i shoqërisë, përveç të tjerave ka të drejtë dhe detyrohet:
 - a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b. të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
 - d. të përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e. të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f. të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

- g. të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h. të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 4. Për të gjitha transaksionet në formën e detyrimeve për shoqërinë, duke përfshirë, por pa u kufizuar të të gjitha shpenzimet për shkak të blerjeve, marrëdhënieve të punës, investimeve, huave apo formave të tjera me apo pa kontratë të shkruar, administratori do të veprojë me miratim paraprak të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë;
 - 5. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje statuti, ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij dhe është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljeve, i cili ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave sipas standarteve të kërkuara.

KREU VI

BILANCI, DIVIDENTËT DHE MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 15

Bilanci

- 1. Çdo vit financiar fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 Dhjetor;
- 2. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme e zakonshme;
- 3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 3 (tre) muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar dhe gjuha që përdoret për hartimin e dokumenteve vjetore është gjuha shqipe.

Neni 16

Dividentët

- 1. Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e Përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendëve mbi fitimin në raport me kuotat që gjithësecili ka në shoqëri.

Neni 17

Marrëdhëniet e Punës

- 1. Shoqëria për të kryer veprimarinë e saj sipas objektit të këtij statuti do të lidhë kontrata individuale për të rregulluar marrëdhëniet e punës. Kontratat e Punës do të lidhen konform ligjit "*Kodi i Punës së Repulikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore të dala për zbatim të tij.

Neni 18

Marrëdhëniet me Bankat



1. Shoqëria, pas miratimit paraprak të Asamblesë së Përgjithshme, ka të drejtë të hap llogari likuiduese pranë një ose më shumë bankave dhe të mund të kryejnë veprime likuiduese pranë tyre. Në këto banka si nënshkrim të parë do të depozitohet ai i administratorit të shoqërisë, i cili duhet të nënshkruajë për të gjitha veprimet financiare në emër dhe për llogari të shoqërisë. Ai mund të autorizojë dhe persona të tjerë brenda shoqërisë.

Neni 19

Marrëdhëniet me Organet Tatimore

1. Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklarin e të ardhurave, dhe t'i depozitojnë ato pranë organit përkatës të tatimeve.

KREU VII

LIKUIDIMI DHE PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 20

Prishja e Shoqërisë

1. Shoqëria priset me përfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj;
2. Shoqëria nuk priset kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarët e radhës së parë të ortakut që vdes.

Neni 21

Likuidimi

1. Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likuidues, i cili i paraqet asaj raportin e likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tij;
2. Në fund të procesit të likuidimit asambleja vendos me vendimin unanim të ortakëve mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe për mbylljen e procesit të likuidimit;
3. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së kuotave të kapitalit tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

Neni 22

Shndërrimi i shoqërisë

1. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" i ndryshuar;

KREU VIII



DISPOZITA TE TJERA

Neni 23

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit midis ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, palët bëjnë përpjekje për zgjidhjen me mirëkuptim dhe në rast se kjo nuk arrihet do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë;
2. Për çështje që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*";
3. Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga themeluesit.

THEMELUESIT E SHOQËRISË:

Z. Agustin Marashi

Shoqëria "ALBES INVEST" sh.p.k

Përfaqësuar nga Administratori

Z. Besnik Paluca

Agustin Marashi

Ag

Besnik Paluca

ALBES INVEST SHPK
NIPT: M17821501K
LEZHE